

VENDIM
Nr. 573, datë 3.8.2016

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 999, DATË 9.12.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI “REHABILITIMI I SHËTITORES KRYESORE ANËS DETIT, HIMARË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Minis-trave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 999, datë 9.12.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në tabelën e përmendur në pikën 3 të vendimit në fuqi shtohen pronarët sipas tabelës nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Në fund të pikës 3, fjalët “... vlerë të përgjithshme të shpronësimit 43 906 145 (dyzet e tre milionë e nëntëqind e gjashtë mijë e njëqind e dyzet e pesë) lekë ...” zëvendësohen me “... vlerë të përgjithshme të shpronësimit 64 471 942.48 (gjashtëdhjetë e katër milionë e katërqind e shtatëdhjetë e një mijë e nëntëqind e dyzet e dy pikë dyzet e tetë) lekë ...”.

3. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit 64 471 942.48 (gjashtëdhjetë e katër milionë e katërqind e shtatëdhjetë e një mijë e nëntëqind e dyzet e dy pikë dyzet e tetë) lekë, të përballohet, si më poshtë vijon:

a) Vlera 19 537 434 (nëntëmbëdhjetë milionë e pesëqind e tridhjetë e shtatë mijë e katërqind e tridhjetë e katër) lekë të përballohet, nga buxheti i Ministrisë së Zhvillimit Urban;

b) Fondi i mbetur për likuidimin e pronarëve, në vlerën prej 44 934 508.48 (dyzet e katër milionë e nëntëqind e tridhjetë e katër mijë e pesëqind e tetë pikë dyzet e tetë) lekë të përballohet nga “Fondi i shpronësimeve”, në llogarinë e shpronësimeve në Bankën e Shqipërisë.

Shpenzimet procedurale në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Zhvillimit Urban.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

Tabela nr. 2

TABELA E PRONARËVE TË SHPRONËSIMIT QE NUK JANË SHPRONËSUAR NGA VKM-ja NR. 999, DATË 9.12.2015 PËR INTERES PUBLIK TE PROJEKTIT
 "REHABILITIMI I SHËTTTORES KRYESORE ANËS DEJTT, HIMARE"

Nr.	Mbie- mër	Emër	Lloji i pasuri- së	Nr. hipotekar/i pasurisë	Zona Kadastra- le	Sipërfaqe e objektit që shpronë- sohet	Çmimi i objektit për njësi, sipas titullit të pronësisë	Vlera e objektit për shpro- nësim	Çmimi i tokës së objektit për njësi sipas VKM-së 514	Vlera e tokës për shpronë- sim në lekë	Vlera totale për shpronësim = vlera e objektit - vlera e tokës në propor- cion me sip.	Vend- ndodhje
1	Gjicali	Fotaq	banesë, kati i parë	244	1952	176 m ²	42561 lekë/m ²	7490736	4350 lekë/m ²	255200	7235536	Spile, Himarë
2	Gjicali	Fotaq	banesë, kati i dytë	244	1952	176 m ²	42561 lekë/m ²	7490736	4350 lekë/m ²	255200	7235536	Spile, Himarë
3	Veizi	Veniamin + Agron	banesë	205	1952	99.75 m ²	61100 lekë/m ²	6094725			6094725	Spile, Himarë
										SHUMA	20565797	